



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVËS

PROFILI I LEHTË I MIGRIMIT

2020

AUTORITETI QEVERITAR PËR MIGRIM

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument, duhet cituar burimin.

MOHIM

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Migrim me mbështetjen e Zyrës Zvicerane për bashkëpunim në Kosovë, përmes projektit të zbatuar nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit (ICMPD) në bashkëpunim me Universitetin e Maastricht-it.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe nuk paraqet këndvështrimet e ICMPD-së, Universitetit të Maastricht ose Sekretariati Shtetëror Zvicran për Migrim dhe Zyrës Zvicrane për bashkëpunim në Kosovë.

Kontakti:

Autoriteti Qeveritar për Migrim
Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Tel: + 383 (0) 38 200 19 545
www.mpb.rks-gov.net
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" 14
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit për vitin 2020

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve në fushën e migrimit për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, organizatat jo-qeveritare, komunitetin akademik/hulumtues, si dhe për palët e tjera të interesit. Dokumenti përmban rekomandime të cilat mund t'i shërbejnë mekanizmave vendimmarrës, me qëllim të përfshirjes së këtyre rekomandimeve në politika shtetërore dhe sektoriale që ndërlidhen me çështjet e migrimit dhe të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Ky dokument pasqyron zhvillimet dhe ndryshimet në politika, legjislacion dhe ato institucionale që kanë ndodhur gjatë vitit 2020, ndërsa në pjesët e dokumentit ku nuk ka pasur zhvillime apo ndryshime, teksti ka mbetur i ngjashëm me profilet e viteve paraprake.

Analiza e trendëve të migrimit e prezantuar në këtë dokument mbulon periudhën 3-vjeçare nga viti 2018 deri në 2020, e paraqitur përmes figurave dhe tabelave, ku përfshihen potencialisht edhe periudhat paraprake të ndonjë ndryshimi të dukshëm të trendëve migruese.

Struktura e dokumentit përfshin zhvillimet e politikave dhe legjislacionit, zhvillimet institucionale, si dhe analizën e të dhënave statistikore që ndërlidhen me fushën e migrimit.

Profili i Lehtë i Migrimit për vitin 2020 është hartuar nga ekspertë dhe zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilët njëherësh janë anëtarë të Autoritetit Qeveritar për Migrim, me përkrahje teknike dhe ekspertizë nga partnerët ndërkombëtarë.

Përmbajtja

Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit për vitin 2020	2
Shkurtesat	5
1. Informata të përgjithshme për shtetin.....	7
1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve	7
1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin	9
2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e migrimit.....	11
2.1 Rrjedhat e migrimit.....	11
3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore	16
3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	16
3.2. Shërbimet e migrimit për çështje të punësimit	17
3.3. Politikat dhe korniza ligjore	17
3.3. Statistikat.....	18
4. Migrimi i parregullt.....	24
4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	24
4.2. Politikat dhe korniza ligjore	25
4.3. Statistikat.....	26
5. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi	33
5.1. Kthimi i të huajve.....	33
5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	33
5.1.2. Politikat dhe korniza ligjore	34
5.1.3. Statistikat.....	34
5.2. Ripranimi	37

5.2.1 Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	37
5.2.2. Politikat dhe korniza ligjore	37
5.2.3. Statistikat.....	38
5.3. Riintegrimi	39
5.3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	39
5.3.2. Politikat dhe korniza ligjore	40
5.3.3. Statistikat.....	41
6. Integrimi i të Huajve.....	44
6.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	44
6.2. Politikat dhe korniza ligjore	44
6.3. Statistikat.....	46
7. Migrimi dhe Zhvillimi.....	48
7.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	48
7.2. Politikat dhe korniza ligjore	49
7.3 Statistikat.....	55
8. Azili.....	60
8.1 Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	60
8.2 Politikat dhe korniza ligjore	60
8.3. Statistikat.....	61
9. Përfundimet dhe rekomandimet	65
9.1 Përfundimet.....	65
9.2 Rekomandimet	66

Shkurtesat

Shkurtesat	Përshkrimi
ADA	Agjencia Zhvillimore e Austrisë
APRK	Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës
AQM	Autoriteti Qeveritar për Migrim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administratat Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DIMAK	Qendra Gjermane e Informimit për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
DHKO	Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar
DHTQNJ	Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Bashkimit Evropian
FRONTEX	Agjencia për Mbrojtjen e Kufijve dhe Bregdetit Evropian
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IOM/ ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
JRS	Shërbimi Jezuit për Refugjatë
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
MF	Ministria e Financave
MIMAK	Projekt 'Fuqizimi i Autoriteteve në Kosovë për Menaxhim të Migrimit'
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë

MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PRE	Programi i Reformave në Ekonomi
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
RAE	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian
SIS	Sistemi Informativ i Shengenit
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UA	Udhëzimi Administrativ
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
VT	Viktima e Trafikimit

1. Informata të përgjithshme për shtetin

1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Gadishullin Ballkanik me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.



Rajoni: Evropa Juglindore

Gjerësia e territorit të Kosovës: 41° 51' 21 dhe 43° 16'

Gjatësia e territorit të Kosovës: 19° 59' dhe 21° 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Gjatësia e kufijve: Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.556 km¹

¹ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit,
http://www.mpb-ks.org/repository/docs/ALB_Strategjia_Kombetare_MIK_2013-2018_12.07.2013.pdf

Sipërfaqja²: 10,908 km²

Vendet fqinje: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë

Popullsia: 1,798,188 (e vlerësuar më 1 Janar 2021)

Dendësia e popullsisë: 164 banorë për 1 km²

Forma e qeverisjes: Republikë Parlamentare

Valuta: Euro (EUR)

Dita e pavarësisë: 17 shkurt 2008

Presidenti: Z. Hashim Thaçi (deri me 5 Nëntor 2020); Znj. Vjosa Osmani (U.D. të Presidentës së Kosovës nga 5 Nëntor 2020)

² Po aty

1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin

Republika e Kosovës është shtet i së drejtës me demokraci parlamentare i bazuar mbi parimin e ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore. Shtylla e tretë është pushteti gjyqësor, i cili është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga gjykatat. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.

Kompetencat administrative në fushën e migrimit dhe azilit ndërthuren në mes të nivelit qendror dhe atij lokal (komunal).

Sistemi për menaxhimin e migrimit në Kosovë është i rregulluar përmes kornizës ligjore³ dhe asaj institucionale. Ministria e Punëve të Brendshme është institucion përgjegjës i cili adreson çështjet e azilit, të huajve, shtetësisë, ripranimit, migrimit të parregullt, si dhe çështjet e riintegrit të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve me qëndrim në Republikën e Kosovës. Institucionet e tjera që kanë përgjegjësi në çështjet e migrimit janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Pushtetit Lokal (MPL), Ministria e Arsimit, Shkencës (MASH), Ministria e Financave (MF), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Integrim Evropian (ZKM), Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Policia e Kosovës (PK), si dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK).⁴

³ Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt, Ligji nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr.06/L-026 për Azil, Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Ligji Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim, Ligji Nr.04/L-076 për Policinë, Ligji Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Ligji Nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, Rregullorja (QRK) Nr. 13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Punësimit. Rregullorja (QRK)-Nr. 06/2020 (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 07/2020) për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

⁴ Bazuar në emërtimet e Ministrive sipas Rregullores (QRK)-Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=28172>.

Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM), i themeluar me Vendim⁵ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është përgjegjës për monitorimin e lëvizjeve migruese dhe funksionon si mekanizëm ndërinstitucional duke përfshirë të gjithë akterët relevantë në fushën e migrimit. AQM-ja është përgjegjëse për hartimin e profileve të migrimit dhe u jep rekomandime autoriteteve shtetërore në fushën e migrimit, si dhe propozon politika të reja në këtë fushë për Qeverinë.

Gjatë vitit 2020 është miratuar Rregullorja (QRK)-Nr. 06/2020 (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 07/2020) për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Me këtë Rregullore janë shfuqizuar: Rregullorja (QRK)-Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Rregullorja (QKR)-Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, Rregulloren Nr. 26/2018 dhe Rregulloren Nr. 30/2018. Rregullorja për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, përderisa emërtimet, përbërja dhe funksionet e Ministrive, për qëllime të këtij dokumenti bazohen në Rregulloren (QRK)-Nr. 06/2020 (plotësuar Rregullorja (QRK)-Nr. 07/2020) për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si akt i fundit ligjor në fuqi gjatë vitit 2020.

⁵ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 08/158, i datës 29 nëntor 2013 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit.

2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e migrimit


Popullsia rezidente në Kosovë në fund të vitit 2020 (1 janar 2021) është vlerësuar të jetë 1,798,188 banorë. Agjencia e Statistikave të Kosovës çdo vit bën vlerësimin e numrit të popullsisë duke përfshirë të dhënat për migrimin, me përdorimin e metodologjisë së standardizuar me qëllim të përfshirjes të të gjitha kategorive të migrantëve.

2.1. Rrjedhat e migrimit

2.1.1 Imigrimi

Sipas vlerësimit të ASK-së, gjatë vitit 2020, imigrantët përbënin 0.64% të popullsisë së përgjithshme rezidente apo 11,543 persona.⁶ Në këtë shifër janë përfshirë të gjitha kategoritë e imigrantëve (shtetas kosovarë të kthyer/ripranuar dhe të huaj) pa marrë parasysh arsyen e imigrimit.

Figura 1: Imigrimi në Kosovë sipas viteve, 2018-2020



Burimi: ASK


⁶ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2020, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2021: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Për periudhën 2018-2020, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar gjatë këtyre viteve janë shtetas kosovarë (migrantë të kthyer/ripranuar dhe të huaj), me një mesatare vjetore prej 8,124 personave apo 0.45% e popullsisë së përgjithshme rezidente brenda një viti.

2.1.2 Emigrimi

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2020, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 8,724 persona⁷ apo 0.49% e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (të rregullt dhe të parregullt).

Figura 2: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve, 2018-2020



Burimi: ASK

⁷ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2020, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2021
<https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Të dhënat për periudhën 2018-2020 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 23,933 personave apo 1.3% të popullatës kosovare.

2.1.3 Migrimi neto

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2020 ishte 2,819 banorë apo 0.16% e popullsisë rezidente. Për periudhën 2018-2020 vlerësohet se nga Kosova kanë emigruar 71,799 banorë.

Tabela 1: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet 2018-2020

Vitet	Imigrimi	Emigrimi	Net migrimi (nr. absolut)	Net migrimi (përqindje)
2018	6,762	28,164	-21,402	-1.19
2019	6,066	34,911	-28,845	-1.62
2020	11,543	8,724	2,819	0.16

Burimi: ASK⁸

2.2. Stoqet e migrimit

2.2.1 Stoqet e Imigrimit

Nëse e krahasojmë vitin 2020 me 2019, kemi rritje rreth 14.7% të imigrantëve përgjatë kësaj periudhe kohore (në këtë grup hyjnë kryesisht kosovar të kthyer/të ripranuar dhe të huaj).

⁸ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2020, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2021: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2018-2020

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i imigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2018	1,795,666	60,672	3.38
2019	1,782,115	66,738	3.74
2020	1,798,188	78,281	4.35

Burimi: ASK

2.2.2 Stoqet e emigrimit

Në krahasim me vitin paraprak, 2019, stoqet e emigrantëve kanë shënuar një rritje prej 0.36%.

Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2018-2020

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i emigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2018	1,795,666	210,170	11.70
2019	1,782,115	245,081	13.75
2020	1,798,188	253,805	14.11

Burimi: ASK

2.2.3 Stoku i migrimit neto

Gjatë viteve 2018-2020, në Kosovë imigruan mbi 24,371 banorë, ndërsa emigruan mbi 71,799 banorë dhe popullata e Kosovë gjatë kësaj periudhe është zvogëluar për më shumë se 47,428 banorë.

Tabela 4: Stoqet e migrimit netotë shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2018-2020

Viti	Gjithsej popullsia	Rrjedhat e imigrimit (nr. absolutë)	Rrjedhat e emigrimit (nr. absolutë)	Rrjedhat neto të emigrimit, sipas viteve	Stoku neto i migrimit (nr. absolutë)	Stoku neto (në raport me shpërndarjen e popullsisë)
2018	1,795,666	6,762	28,164	-21,402	854,198	47.57
2019	1,782,115	6,066	34,911	-28,845	883,043	49.55
2020	1,798,188	11,543	8,724	2,819	885,862	49.26

Burim: ASK

Të dhënat bazë për rrjedhën e migrimit janë marrë nga të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, duke u bazuar në të dhënat e censusit të datës 1 prill 2011. Sipas këtij vlerësimi, më shumë se 550,000 banorë kosovarë kishin emigruar nga Kosova prej vitit 1969, derisa popullsia e vlerësuar me prejardhje kosovare, duke përfshirë personat e lindur jashtë Kosovës, është vlerësuar të jetë 885,862 banorë.

3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore

Ky kapitull përmban informacione të nevojshme rreth të dhënave dhe shërbimeve të këshillimit lidhur me menaxhimin e migrimit të rregullt, me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore. Politikat që ndërlidhen me menaxhimin e migrimit të rregullt janë përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).⁹

3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Divizioni për të Huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), është autoriteti shtetëror përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për pajisje me lejet e qëndrimit të përkohshëm (përfshirë edhe lejet e qëndrimit me qëllim punësimi), dhe të përhershme në Republikën e Kosovës. DSHAM¹⁰ vendos edhe pa miratimin e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) për lejet e qëndrimit për qëllim pune, përderisa nuk ka kuotë vjetore për punësimin e të huajve, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në bazë të Ligjit për të Huaj¹¹, APRK/MPMS¹² lëshon leje pune afatshkurtër për të huaj, me kohëzgjatje prej 90 ditëve, brenda një periudhë kohore prej 180 ditëve, gjatë një viti.

Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK-ja) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale për të huajt, të cilët kanë qasje në tregun e punës në Republikën e Kosovës. APRK-ja gjithashtu ofron informacion, shërbime këshillimi dhe orientim në karrierë, zhvillim të shkathtësive profesionale, dhe ndërmjetësim të punësimit për punëkërkuesit kosovarë të cilët kërkojnë punësim jashtë vendit.

⁹ Bazuar në Rregulloren (QRK) – Nr. 06/2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=28172>

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876> (neni 20 paragrafi 6)

¹¹ Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt

¹² Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

3.2. Shërbimet e migrimit për çështje të punësimit

Gjatë vitit 2020, situata e krijuar nga pandemia Covid-19 ka ndikuar në rënien e aplikimeve për leje pune afatshkurtra në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2020, Divizioni i Shërbimeve të Migrimit në kuadër të APRK-së, ka avancuar kapacitetet e të zyrarëve për këshillim punësimi, përfshirë shërbimet e migrimit, përmes trajnimeve dhe kurseve të ndryshme, në bashkëpunim me Autoritetin Qeveritar për Migrim (AQM-në), projektin MIMAK, GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK).

Në tetor të vitit 2020, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës ka arritur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë për Mobilitetin në Punë, mbi çështjet e punësimit dhe aftësimeve profesionale bazuar mbi orientimet e BE-së, zotimet që dalin nga procesi i Berlinit, bashkëveprimet ndërkufitar në kuadër të përafrimit të masave në lidhje me mobilitetin për punë dhe politikat e përbashkëta. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përforcimi i marrëdhënieve mes agjencive zbatuese të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mundësinë e punësimit të punëtorëve nga secili shtet në territorin e shtetit tjetër.

3.3. Politikat dhe korniza ligjore

Migrimi i rregullt (imigrimi) në Republikën e Kosovës, duke përfshirë imigrimin për qëllime punësimi është i rregulluar me Ligjin për të Huajt¹³ dhe akte të tjera ligjore.

Gjatë vitit 2020, nuk ka patur zhvillime në kontekst të hartimit të politikave dhe legjislacionit që ndërlidhet me migrimin e rregullt, në veçanti lidhur me migrimin për qëllime punësimi.

¹³ Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333>

Megjithatë, Plani Legjislativ për vitin 2020 ka paraparë hartimin dhe plotësim-ndryshimin e një numri të akteve ligjore dhe nënligjore, si në vijim:

- Hartimi i koncept dokumentit për plotësim-ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-219 për të Huaj dhe Ligjit Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-219 për të Huaj;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Shpalljen e një të Huaji Person i Padëshiruar;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.02/2014 për Dokumentet e Udhëtimit për të Huajt;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.01/2015 për Themelimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huaj.

3.4. Statistikat


3.4.1 Imigrimi i rregullt

Gjatë vitit 2020 janë lëshuar gjithsej 3,429 leje qëndrimi të përkohshme për të huaj të gjitha kategorive që në krahasim me vitin paraprak (4,935) ka pasur një rënie prej -31%. Për qëllime punësimi janë lëshuar 1,770 (51.6%), për kategorinë e bashkimit familjar janë lëshuar 1,444 (42%), për studim/shkollim janë lëshuar 201 (5.9%) dhe për arsye të tjera janë lëshuar 14 (0.4%) leje qëndrimi të përkohshme.

Sipas gjinisë, nga numri i vendimeve pozitive për leje qëndrim të përkohshëm, 1,915 (56%) i takojnë gjinisë femërore, kurse 1,514 (44%) gjinisë mashkullore.

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshme të lëshuara sipas shteteve është si në vijim: Shqipëria me 940 (27.4%), Serbia me 700 (20.4%), Turqia me 659 (19.2%), Maqedonia e Veriut me 354 (10.3%), SHBA me 125 (3.6%), dhe shtete të tjera me 651 (19%).

Figura 3: Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas vitit, 2018-2020



Burimi: MPB/DSHAM

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi gjatë vitit 2020 ka pasur një trend në rënie prej -28%. Faktorët që mund të kenë ndikuar në këtë rënie të punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës për vitin 2020, mund të jenë të ndërlidhura masat e ndërmarr nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me menaxhimin e pandemisë me Covid-19, mbyllja e kufirit dhe kufizimi i lirisë së lëvizjes, si dhe me përfundimin e projekteve të kompanive të huaja.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi janë: Shqipëria me 454 (25.6%), Turqia me 402 (22.7%), Serbia me 234 (13.2%), Maqedonia e Veriut me 178 (10%), SHBA me 103 (5.8%), dhe shtetet e tjera me 399 (22.5%).


3.4.2 Lejet e qëndrimit të përhershëm

Numri i përgjithshëm i lejeve të qëndrimit të përhershëm të lëshuara gjatë vitit 2020 ishte 142, i njëjtë me vitin 2019 (142).

Nga numri i përgjithshëm i lejeve të qëndrimit të përhershëm të lëshuara sipas gjinisë, 75 (53%) janë meshkuj, kurse 67 (47%) janë femra.

Arsyet e lëshimit të lejeve të qëndrimit të përhershëm sipas kategorive janë si në vijim: punësim 44 (31%), bashkim familjar 36 (25.3%), dhe arsye të tjera 62 (43.6%).

Figura 4: Numri i lejeve të qëndrimit të përhershëm me qëllim të punësimit sipas vitit, 2018-2020



Burimi: MPB/DSHAM

Lejet e qëndrimit të përhershëm janë lëshuar kryesisht për shtetasit nga: Serbia (43 apo 30.3%), Shqipëria (35 apo 24.6%), Turqia (13 apo 9.2%), Maqedonia e Veriut (9 apo 6.3%), Egjipti (5 apo 3.5%), dhe shtete të tjera (37 apo 26.1%).


3.4.3 Leje pune afatshkurta¹⁴

Gjatë vitit 2020 janë lëshuar 70 Leje Pune Afatshkurta për Shtetas të Huaj, ku nga ky numër 2 leje pune afatshkurta kanë qenë vazhdim nga viti paraprak. Numri i Lejeve të Punës Afatshkurtër për të Huajt në vitin 2020 ka shënuar rënie për 71% krahasuar me vitin 2019 si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe ndërlidhet me kufizimet të lëvizjes në Kosovë dhe në botë për të parandaluar

¹⁴ Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 22, Leja e punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

shpërndarjen e Covid-19 si dhe mbyllja e kufijve. Numri i lejeve të punës afatshkurtra të dhëna sipas shteteve janë si në vijim: Kroacia me 20%, Shqipëria me 19%, Maqedonia e Veriut me 14%, Gjermania me 12%, Rumania me 12%, kurse shtetet tjera me rreth 23%.

Figura 5: Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit, 2018-2020



Burimi: MPMS


3.4.4 Emigrimi i rregullt

Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen

Për shtetasit e Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2020, kishte 31,763 leje qëndrimi të vlefshme të të gjitha kategorive në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen. Numri i lejeve të vlefshme të qëndrimit të lëshuara, bazuar në të dhënat e Eurostat-it kishte një rënie për 30% krahasuar me vitin paraprak (45,671).

Gjatë vitit 2020, 51% të të gjitha lejeve të qëndrimit ishin të lidhura me bashkim familjar, 26.4% për qëllim punësimi, 1.5% për qëllim të arsimimit, ndërsa leje qëndrime të klasifikuara për arsye të tjera përbënin 21% të të gjitha kategorive. Gjatë kësaj periudhe me leje qëndrim të vlefshme të shtetasve të Republikës së Kosovës prin Gjermania me 15,895 (50%), e pasuar nga Kroacia me 4,488 (14%), Sllovenia me 3,904 (12%), Franca me 1,577 (5%), Italia me 1,388 (4.4%) dhe shtetet tjera me 4,511 (14%).

Figura 6: Emigrantët kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Shengen, sipas arsyes së qëndrimit, 2018-2020



Burimi: Eurostat¹⁵


3.4.5 Lirimi i Shtetësisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2020, kanë parashtruar kërkesë për lirim të shtetësisë së Republikës së Kosovës 3,557 persona, ndërsa 3,633 persona janë liruar nga shtetësia, si dhe 37 janë refuzuar për mos plotësimin e kriterëve ligjore. Krahasimi i të dhënave të viteve 2019/2020 tregon se në vitin 2020 ka një rënie të vendimeve pozitive prej -33% poashtu rënie të vendimeve negative prej -45%.

¹⁵ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>

Sipas shteteve në vitin 2020, personat të cilët janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, 84% (3,044) janë nga Gjermania, 11.6% (422) nga Austria, 2% (71) nga Sllovenia dhe 2.64% (96) nga shtetet e tjera.

Figura 7: Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, 2018-2020



Burimi: DSHAM

Gjatë periudhës 2018-2020, trendët e lirimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës kanë qenë në rënie. Gjatë kësaj periudhe janë liruar 14,490 persona, ku dominon gjinia mashkullore me 52% (7,506) krahasuar me gjininë femërore 48% (6,984).

4. Migrimi i parregullt

Migrimi i parregullt ka mbetur një sfidë për institucionet e Republikës së Kosovës, në veçanti në menaxhimin e lëvizjeve të përziera të migrantëve duke shfrytëzuar territorin e Republikës së Kosovës. Me shpërthimin e pandemisë dhe mbylljen e kufijve gjatë vitit 2020, është rritur nevoja për zgjerimin e kapaciteteve akomoduese për migrantë dhe refugjatë.

4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave që ndërlidhen me migrimin e parregullt, si dhe për zbatimin e politikave që ndërlidhen me imigrim të parregullt në Republikën e Kosovës.

Departamenti i Policisë Kufitare, në kuadër të Policisë së Kosovës, është përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Në kuadër të këtij Departamenti, funksionon Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) e cila ka mandat për kontrollimin e hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimi të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar (DHKO) në kuadër të Departamentit të Hetimeve merren me parandalimin dhe luftimin e kontrabandimit me migrantë.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), është drejtori e specializuar e Policisë së Kosovës e ngarkuar me përgjegjësinë për hetimin e rasteve dhe veprave të tjera që ndërlidhen me trafikimin me njerëz.

4.2. Politikat dhe korniza ligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar politikat dhe kornizën ligjore¹⁶ me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt, luftimit të kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore. Gjatë vitit 2020 është miratuar Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për refuzimin e hyrjes në Republikën e Kosovës. Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet mënyra e refuzimit të hyrjes në Republikën e Kosovës për personat e huaj të cilët nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin për të Huajt. Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të transpozoi pjesërisht Rregulloren (BE) 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 mars 2016 për Kodin e Unionit që rregullon udhëheqjen e lëvizjes së personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve të Shengenit) dhe Rregulloren (EC) Nr. 1987/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 dhjetor 2006 për krijimin, funksionimin dhe përdorimin e Sistemit të Informacionit Shengen të gjeneratës së dytë (SIS II).

Me shpërthimin e pandemisë në fillim të vitit 2020, janë ndërmarr masat e nevojshme lidhur me menaxhimin e migrantëve konform vendimeve të Qeverisë, përfshirë këtu edhe krijimin e hapësirave për karantinimin e migrantëve që kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe ndërmarrjen e masave mbrojtëse ndaj pandemisë për migrantët dhe azil-kërkuesit.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Kosovës, (KPK); Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK); Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur; Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit; Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt; Ligji Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit; Ligji Nr.04/L-125 për Shëndetësi; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015-2019; Strategjia e punës e DHTQNJ-së dhe Plani Vjetor i Veprimit; Aktet e tjera normative të PK-së, Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës, (Udhëzimet Administrative, Parimet, Procedurat Standarde të Operimit dhe vendimet); Procedurat Standarde të veprimit për viktimat e trafikimit; Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit; Strategjia afatgjate për riintegrimin e viktimave të trafikimit.

4.3. Statistikat

4.3.1 Imigrimi i parregullt

Refuzimi i hyrjeve

Të dhënat nga viti 2020 tregojnë se numri i përgjithshëm i personave të cilëve iu është refuzuar hyrja në pikat e kalimit kufitar (PKK) është 3,082, duke shënuar një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2019 dhe 53% krahasuar me vitin 2018.

Tabela 5: Refuzim i hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare, 2018-2020

Viti	2018	2019	2020
Numri i personave	2,016	3,029	3,082


Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës.

Nga numri i përgjithshëm i personave të refuzuar në hyrje të kufirit në vitin 2020, prej tyre 78% janë nga vendet e rajonit, 12% nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, 6% nga shtetet aziatike, dhe 4% nga shtetet tjera. Arsytet për refuzim të hyrjeve në kufi për shtetasit e vendeve fqinje si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ishte mungesa e dokumenteve të vlefshme, ose ndalesat për të hyrë në Republikën e Kosovës, ndërsa për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen ishte mungesa e letërnjoftimeve biometrike apo pasaportave dhe mungesa e testeve negative për Covid-19. Shtetasve të shteteve aziatike dhe afrikane u është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së vizës, mjeteve të pamjaftueshme financiare, mosjustifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit si dhe mungesa e testeve negative për Covid-19.

4.3.2 Kalimi i paautorizuar i kufirit

Gjatë vitit 2020, numri i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar ka qenë 2,564. Krahasuar me vitin 2019 (2,027), vërehet një rritje prej 26%, ndërsa në krahasim me vitin 2018 (505) ka pasur rritje prej afro 4 fish më shumë (408%).

Figura 8: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2018-2020



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës

Nga numri i përgjithshëm i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar (2,564), numri më i madh i tyre është nga Siria (1,330), Maroku (310), Palestina (229), Iraku (197), Libia (139), Algjeria (107) dhe shtetet tjera (252). Gjinia mashkullore përfaqësohet me 92% (2,360) imigrantë të parregullt, ndërsa gjinia femërore me 8% (204). Për nga grup-mosha, 14% imigrantë të parregullt ishin të moshës nën 18 vjeç, ndërsa 86% të moshës madhore (mbi 18 vjeç). Rastet e trajtuara na tregojnë se imigrantët e parregullt kanë lëvizur në grupe të vogla, të ndihmuar nga kontrabandistët. Këta imigrantë kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës kryesisht përmes kufirit me Shqipërinë me 94% (2,404) të rasteve, pasuar nga kufiri me Serbinë me 4% (110) të rasteve, dhe kufirit me Maqedoninë e Veriut me 2% (50) të rasteve.

4.3.3 Luftimi i kontrabandimit me migrantë

Gjatë vitit 2020, Policia e Kosovës ka vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kontrabandimit me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Gjatë vitit 2020, Policia e Kosovës ka inicuar 25 raste për dyshimin e kryerjes së veprës penale të kontrabandës me migrantë, një rast më shumë se në dy vitet paraprake.

Numri i personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë gjatë vitit 2020 ishte 34, krahasuar me vitin 2019 ka rënie 3% (35), ndërsa me vitin 2018 ka rritje për 70% (20).

Nga 34 persona të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 79% ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 12% shtetas të Republikës së Shqipërisë, 6% të Serbisë dhe 3% shtetas Turk.

Tabela 6: Të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shtetësisë, 2018-2020

Shtetësia	2018	2019	2020
Kosovë	12	24	27
Shqipëri	5	3	4
Serbi	2	1	2
Turqi	1	1	1
Maqedonia e veriut	0	3	0
Siria	0	2	0
Iraku	0	1	0
Total	20	35	34

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

4.3.4 Trafikimi me Qenie Njerëzore

Të dhënat vjetore tregojnë se gjatë vitit 2020 nuk është identifikuar asnjë viktimë e trafikimit (e huaj), krahasuar me vitin 2019 që ishin 5 viktima të identifikuara, dhe kjo tregon një rënie të kësaj dukurie.

Siç dihet në vitin 2020 përveç luftimit dhe angazhimet policore dhe gjithë institucioneve në luftimin dhe parandalimin e Trafikimit me Njerëz, ka ndikuar edhe pandemia me Covid-19 dhe masat kufizuese që janë marrë nga të gjitha shtetet për kufizim të lirisë së lëvizjes /mbyllje të kufijve.

Tabela 7: Viktimat e trafikimit sipas shtetësisë, 2018-2020

Viktima të Trafikimit të identifikuara/origjina	2018	2019	2020
Shqipëri	2	1	0
Çeki	1	0	0
Mali i zi	0	2	0
Serbi	0	2	0
Totali	3	5	0

Burimi: Drejtoria për Hetimin dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore, Policia e Kosovës

4.3.5 Emigrimi i parregullt

Kjo pjesë pasqyron emigrimin e parregullt të shtetasve të Republikës së Kosovës drejt shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen. Të dhënat e paraqitura në dokumente janë të bazuara në burimet dhe statistikën e publikuara nga Eurostat. Si rezultat i Brexit-it, Mbretëria e Bashkuar nuk është përfshirë në këto të dhëna.

4.3.5.1 Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë kapur në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen

Në vitin 2020, rreth 1,255¹⁷ shtetas të Republikës së Kosovës u refuzuan ose u zunë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Shengen, që në krahasim me vitin paraprak kishte një rënie prej -16% (1,460). Nga numri i përgjithshëm i refuzimeve të regjistruara, rreth 3/4 ishin nga vendet si: Kroacia (355 ose 28%), Sllovenia (310 ose 25%), Hungaria (260 ose 21%) dhe shtetet tjera (330 ose 26%).

Kryesisht refuzimet ishin në rrugët tokësore me (1,010 ose 81%), ajrore (180 ose 15%) dhe rrugë detare (55 ose 4%).

Arsyet kryesore për refuzimin e hyrjes në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe zonës Shengen ishin, më shumë se 3/4 ose 81% e numrit të përgjithshëm nuk kishin vizë apo leje-qëndrim të vlefshëm, 9% nuk kishin dokumente të vlefshëm, 8% kishin dokumente të udhëtimit të falsifikuara dhe 2% kishin vizë apo leje qëndrimi të falsifikuar.

Trendi gjatë tri viteve të fundit (2018-2020) i shtetasve kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë kapur në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen ka qenë vazhdimisht në rënie.

Nga numri i përgjithshëm i të gjitha refuzimeve të hyrjes në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen (139,275), shtetasit kosovare përbënin 0.91%.

4.3.5.2 Shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen

Numri i shtetasve kosovarë të cilët u zunë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, për vitin 2020, ishte gjithsej 4,515¹⁸ persona. Krahasuar me vitin 2019 (5,390), kishte një rënie prej -19%.

¹⁷ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar më, 08 qershor 2021 dhe qasur më 14 qershor 2021.

¹⁸ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar më 11 qershor 2021 dhe qasur më 30 qershor 2021.

Shtetet Anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, që raportuan numër më të madh të shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt në vitin 2020, ishin: Gjermania (1,690, ose 38%), e pasuar nga Zvicra (810, ose 18%), Franca (545, ose 12%), Austria (460, ose 10%), Kroacia (370, ose 8%) dhe shtetet tjera (635, ose 14%). Vetëm në tri shtetet anëtare të BE-së (Gjermania, Franca, Austria), me qëndrim të parregullt u zunë 2,695, ose 60%, të shtetasve kosovarë.

Nga numri i përgjithshëm i të gjithë shtetasve jo-anëtarë të BE-së që rezultuan se ishin me qëndrim të parregullt të pranishëm në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen (570,205), shtetasit kosovarë përbënin rreth 0.3%.

Sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 81%, të atyre me qëndrim të parregullt në krahasim me gjininë femërore e cila përbënte 19%. Megjithatë, kjo përqindje ishte më e lartë sesa pjesa përkatëse e regjistruar në dy vitet paraprake, kur gjinia mashkullore përbënte një mesatare prej rreth 76%, të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës të pranishëm në mënyrë të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen. Sa i përket grupmoshave, 18-34 vjeç përbënin 92% të numrit të përgjithshëm, ndërsa 8% ishin të moshës nën 18 vjeç.

4.3.5.3 Shtetasit kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen me urdhër për largim

Numri i shtetasve të Republikës së Kosovës të urdhëruar për t'u larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen që nga viti 2018, është në rënie të vazhdueshme. Në vitin 2020, numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen ishte 4,280¹⁹, krahasuar me vitin paraprak (5,805), kishte një rënie prej rreth -36%.

Në vitin 2020 nga numri i përgjithshëm, 50% të urdhër largimeve ishin nga Franca (1,540, ose 36%) dhe Gjermania (585, ose 14%), përderisa urdhër largimet tjera u regjistruan në Kroaci (485, ose 11%), Slloveni (340, ose 8%), Zvicër (310, ose 7%), dhe shtetet tjera (1,020, ose 24%).

Nga numri i përgjithshëm i të gjitha urdhër largimeve të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen (400,395), shtetasit kosovare, përbënin rreth 0.9%.

¹⁹ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar me 02 maj 2021 dhe qasur me 02 korrik 2021.

4.3.5.4 Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen në bazë të urdhrit për largim


Në vitin 2020, numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë, të cilët u larguan në bazë të një urdhri për largim nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, ishte 1,410.²⁰ Ky numër, krahasuar me një vit më parë (2,465) shënon një rënie të konsiderueshme prej rreth -75%, të larguarve shtetas kosovarë nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen.

Një ndër arsytet e kësaj rënie është situata pandemike me Covid-19, ku shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, ndërmorën masa për mbylljen e kufijve të brendshëm, kufizimeve të udhëtimit, shtyrjes së afateve të vendimeve të kthimit dhe zbatimin e kthimit.

Numri më i madh i shtetasve kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen në bazë të urdhrit për largim sipas shteteve kryesonte: Gjermania (375, ose 27%), Kroacia (280, ose 20%), Suedia (150, ose 11%), Austria (140, ose 10%), Sllovenia (135, ose 9%) dhe shtetet e tjera me (330, ose 23%).

²⁰ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar me 20 maj 2021 dhe qasur me 05 korrik 2021.

Figura 9: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi; janë zënë me qëndrim të parregullt janë urdhëruar të largohen dhe janë larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, 2018-2020



Burimi: Eurostat

5. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi

Ky kapitull përfshin një përmbledhje të procesit të kthimit, ripranimit dhe riintegrit, me të dhëna të hollësishme rreth numrit të të kthyerve vullnetarë dhe atyre të kthyer me forcë. Kapitulli mbulon kthimin e shtetasve të huaj, si edhe kthimin e kosovarëve në vendin e tyre si dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

5.1. Kthimi i të huajve

5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (në kuadër të MPB-së) dhe Policia Kufitare e Kosovës, janë autoritetet përgjegjëse për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, në vendet e origjinës apo në vendin e fundit të qëndrimit të të huajve.

5.1.2. Politikat dhe korniza ligjore

Është kompletuar korniza ligjore lidhur me kthimin e të huajve në vendet e origjinës dhe nuk ka patur zhvillime të reja legislative dhe të politikave.

Gjatë vitit 2020 janë hartuar Rregullat e brendshme që kanë për qëllim informimin e të huajve në kuadër të Qendrës për Mbajtjen e të Huajve.


Gjatë vitit 2020 ka vazhduar zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në fushën e menaxhimit të migrimit “Kthimi i asistuar vullnetar dhe riintegrimi”. Si rezultat i zbatimit të kësaj marrëveshje është bërë kthimi i 1 të huaji (nga Iraku).

5.1.3. Statistikat

5.1.3.1 Vendimet për largim vullnetar

Të dhënat tregojnë se në vitin 2020, është shënuar rënie e vendimeve për largim vullnetar nga territori i Republikës së Kosovës për 54% në krahasim me vitin 2019 dhe 16% në krahasim me vitin 2018.

Figura 10: Vendimet për largim vullnetar, 2018-2020



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të Dhënave, Departamenti i Kufirit


Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetar sipas shteteve ishin për shtetasit e Shqipërisë me 57 vendime (38%), Turqisë me 35 vendime ((25%), Serbisë 15 vendime (10%), Maqedonisë së Veriut 9 vendime (6%), kurse 32 vendime (18%) ishin nga shtetet e tjera.

Në bazë të këtyre të dhënave, te numri i vendimeve për largim vullnetar të kategorizuara sipas gjinisë ka dominuar gjinia mashkullore me 61%, krahasuar me gjininë femërore me 39%. Ndër arsyet e lëshimit të vendimeve për largim vullnetar për të huajt me qëndrim të parregullt në Republikën e Kosovës, ka qenë mungesa e lejes së vlefshme të qëndrimit, anulimi ose revokimi i lejes së qëndrimit, ose janë gjetur duke punuar në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin për të Huajt ose me ligjet e tjera në fuqi.

5.1.3.2 Vendimet për largim me forcë

Nga territori i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020, janë ekzekutuar gjithsej 95 vendime për largim me forcë, që paraqet një rënie prej 14% në krahasim me vitin 2019 dhe 61% krahasuar me vitin 2018.

Figura 11: Vendimet për largim me forcë, 2018-2020




Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huajt

Sipas gjinisë, 54% e të deportuarve me vendim për largim me forcë kanë qenë të gjinisë femërore ndërsa 46% të gjinisë mashkullore. Sipas shtetësisë, 88% kanë qenë nga Shqipëria, 6% nga Serbia dhe 6% nga vende të tjera.

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj me vendim të gjykatave të Kosovës ka deportuar nga Republika e Kosovës 34 persona, duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Krahësuar me vitin 2019 kemi një rritje për 3% (33), ndërsa me vitin 2018 një rritje prej 42% (24). Nga këto deportime, 19 persona ishin shtetas të Serbisë, 7 të Shqipërisë, 4 të Turqisë, 2 të Bosnje dhe Hercegovinës, 1 shtetas i Kinës dhe 1 shtetas i Indisë.

Figura 12: Vendimet për largim me vendim gjykatë, 2018-2020



Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

5.2. Ripranimi

5.2.1 Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim/Divizioni për Ripranim dhe Kthim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-208 për Ripranim, si dhe të marrëveshjeve bilaterale të ripranimit.

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë Kufitare është përgjegjës për lejimin apo refuzimin e kërkesave për kalim tranzit të shtetasve të vendeve të treta.

5.2.2. Politikat dhe korniza ligjore

Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkuar. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi në aspektin e bashkëpunimit për ripranimin me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Gjatë vitit 2020 Udhëzimi Administrativ Nr.09/2011 për zbatimin e ligjit për Ripranim ka qenë në plotësim ndryshim dhe ka kaluar të gjitha fazat e konsultave paraprake dhe publike.

Gjatë vitit 2020 ka vazhduar zbatimi i ligji nr. 03/L - 208 për ri pranim si dhe marrëveshjeve të ri pranim.

Deri në vitin 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende²¹, 20 prej të cilave janë vende anëtare të BE-së dhe vendet e Shengenit.

²¹ Ligji Nr.03/L-208 Për Ripranim, 2009 Republika e Shqipërisë, 2009 Republika e Francës, 2010 Këshilli Federal Zviceran, 2010 Republika Federale e Gjermanisë, 2010 Mbretëria e Danimarkës, 2010 Republika e Austrisë, 2010 Mbretëria e Norvegjisë, 2011 Republika e Sllovenisë, 2011 Beneluxi (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg), 2011 Republika e Çekisë, 2011 Mali i Zi, 2011 Mbretëria e Suedisë, 2011 Republika e Finlandës, 2012 Republika e Hungarisë, 2012 Republika e Bullgarisë, 2012 Republika e Maltës, 2013 Republika e Estonisë, 2013 Principata e Lihtenshtajnit, 2013 Republika e Kroacisë, 2014 Republika e Italisë, 2015 Republika e Turqisë dhe 2017 Republika e Maqedonisë së Veriut.


5.2.3. Statistikat

Gjatë vitit 2020 janë ripranuar 625 persona, që përbën një rënie prej -59% krahasuar me vitin paraprak (1,536). Sipas mënyrës së ripranimit, 82% (512) janë ripranuar me forcë, kurse 18% (113) janë të kthyer vullnetarë të asistuar nga IOM-i.

Në bazë të të dhënave vjetore, sipas strukturës gjinore dhe moshës, nga shtetasit kosovarë të ripranuar me forcë gjatë vitit 2020, 80% (411) janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 20% (101) të gjinisë femërore. Gjinia mashkullore përbën përqindjen më të madhe të të ripranuarve me forcë mbi 70%, të cilët janë të moshës ndërmjet 18-34 vjeç (391 ose 44%). Kjo tregon se ata që ripranohen janë të moshës së re (aktive për punë).

Sipas të dhënave nga IOM, të kthyerit e asistuar vullnetarë tregojnë një rritje në përqindjen e gjinisë mashkullore 66.4% (75), krahasuar me gjininë femërore me 33.6% (38).

Figura 13: Ripranimi vullnetar dhe me forcë, 2018-2020



Burimi: DSHAM, IOM

Sipas moshës përqindja më e madhe e të ripranuarve (me forcë dhe të asistuar vullnetar) janë të grup-moshave 18-34 vjeçare (271 ose 43.4%), 35-64 vjeçare (208 ose 33.3%), janë me numër më të madh të ripranuarve ndërsa grupmoshat tjera me 146 ose 23.3%.

Sipas të dhënave vjetore për vitin 2020 (625), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë dhe të asistuar vullnetar) janë nga Gjermania 52.8% (330), Franca 18% (112), Belgjika 3.36% (21) dhe shtetet të tjera me 26% (162). Ndërsa sipas të dhënave vjetore për vitin 2019 (1,536), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë dhe të asistuar vullnetar) janë nga Gjermania 54.6% (839), Franca 22.2% (342), Suedia 3.4% (53) dhe shtetet të tjera me 20% (302).

Nga këto dhëna mund të shohim se trendi i ripranimit (me forcë dhe të asistuar vullnetar) gjatë tre viteve të fundit (2018-2020) është në rënie.

Rreth 94% e rasteve të ripranimit u trajtuan në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me vendet anëtare të BE-së, 5% e rasteve të ripranimit u bazuan në marrëveshjet dypalëshe të ripranimit me vendet jo anëtare të BE-së, ndërsa më pak se 1% e rasteve të ripranimit u trajtuan në përputhje me Ligjin për Ripranim.

5.3. Riintegrimi

5.3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe mbështetjen e riintegrit të personave të riatdhesuar.²²

²² Rregullore (QRK) Nr. 36/ 2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9002>

5.3.2. Politikat dhe korniza ligjore

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me riintegrimin e personave të riatdhesuar, janë të përcaktuar me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Planin e Veprimit 2018–2022²³.

Institucionet tjera përgjegjëse, kriteret dhe procedurat ndihmëse dhe mbështetëse të personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegritit rregullohen përmes Rregullore (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 21 Shator 2020, e cila ka për qëllim avancimin e kornizës ligjore për riintegrimin e personave të riatdhesuar.²⁴

Në kuadër të avancimit të politikave të riintegritit, gjatë vitit 2020 janë hartuar dokumentet si në vijim:

- Është hartuar “Udhëzuesi për Trajtimin Psiko-Social të personave të riatdhesuar” dhe “Manuali për vlerësimin e nevojave dhe ofrimin e mbështetjes “Psiko-Sociale për personat e riatdhesuar”.
- Ka vazhduar analiza e zbatimit të Strategjisë së Riintegritit për periudhën 2018 – 2019 si përgatitje për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Riintegritit për periudhën 2020-2022, me mbështetjen e GIZ-it.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të politikave të riintegritit gjatë kësaj periudhe, Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR, ka vazhduar bashkëpunimin dhe bashkërendimin me institucionet në nivel qendror dhe lokal, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, dhe me ato që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi²⁵. Gjatë vitit 2020, Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për transferimin e buxhetit për zbatimin e ‘skemës së akomodimit me qira për personat e

²³ <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40273>

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>

²⁵ Marrëveshjet përfshijnë institucione qeveritare, organizata të shoqërisë civile dhe donatorë të ndryshëm (MASHT, MPMS, GIZ, UNDP, Kryqi i Kuq).

riatdhesuar', si masë e përkrahjes emergjente të personave të riadhesuar si dhe përcaktimi i obligimeve të ndërsjella institucionale.

5.3.3. Statistikat

Gjatë vitit 2020, në kuadër të skemave të ndryshme emergjente dhe të riintegritit të qëndrueshëm janë mbështetur 6,132 persona të riadhesuar²⁶, ka pasur një rënie të lehtë prej - 0.23% (7,979) krahasuar me vitin 2019. Kjo rënie mund të ketë ndikuar edhe për shkak të rrethanave dhe masave për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Sipas përkatësisë etnike²⁷ numri më i madh i përfituesve gjatë vitit 2020 i takon komunitetit Shqiptar me 73.7% (595), komunitetit Ashkali 9.2% (74), Rom me 7.9% (64), Egjiptian 4.34% (35) si dhe komunitete të tjera.

Ndërsa, sipas komunave të origjinës për vitin 2020,²⁸ numri më i madh i përfituesve në skemat e ndryshme nga buxheti i riintegritit është nga komuna e Mitrovicës me 11.9% (96), Podujevës me 11.6% (94), Prishtinës me 10.5% (85), Vushtrrisë me 6.6% (53) si dhe Gjakovës me 6.6% (53) dhe komunat tjera me 52.7% (426).

Numri më i madh i personave që kanë përfituar nga skemat e ndryshme nga buxheti i riintegritit janë të riadhesuarit nga Gjermania me 67.4% (544), Siria me 13.6% (110), Franca me 5.6% (45), Suedia me 4.2% (34), Zvicra me 2.6% (21), etj.²⁹

²⁶ Sqarim - Numri i përfituesve prej 6,132 pasqyron personat e riadhesuar të ri dhe të bartur edhe nga vitet e kaluar por të mbështetur në skemat e ndryshme për riintegritim gjatë vitit 2020 nga DRPR/Buxheti i Riintegritit dhe Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare që mbështesin procesin e riintegritit, prej tyre (3,224 persona përfitues janë Institucionet Vendore që përfshin 807 persona përfitues nga Departamenti për Riintegritim e Personave të Riatdhesuar/Buxheti i Riintegritit dhe 2,417 persona nga institucionet tjera vendore si dhe (2,908 persona nga Organizatat Ndërkombëtare që mbështesin procesin e riintegritit).

²⁷ Sqarim - numri i përfituesve i cekur në tekste sipas përkatësisë etnike, pasqyron personat përfitues në skemat e ndryshme vetëm nga buxheti i riintegritit DRPR-ja, sepse nga institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare janë pranuar të dhëna statistikore në mënyrë gjeneralë pa të dhëna specifike.


²⁸ Sqarim - numri i përfituesve i cekur në tekste sipas komunave të origjinës dhe shteteve të kthimit pasqyron personat përfitues në skemat e ndryshme vetëm nga buxheti i riintegritit DRPR-ja, sepse nga institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare janë pranuar të dhëna statistikore në mënyrë gjeneralë pa të dhëna specifike.

²⁹ Sqarim - numri i përfituesve i cekur në tekste sipas shteteve të kthimit pasqyron personat përfitues në skemat e ndryshme vetëm nga buxheti i riintegritit DRPR-ja, sepse nga institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare janë pranuar të dhëna statistikore në mënyrë gjeneralë pa të dhëna specifike.

Nga skemat për Riintegrim gjatë vitit 2020 dhe 2019, kanë përfituar gjithsej 107 familje me 371 anëtarë të riatdhesuar që i takojnë grupeve të cënueshme³⁰, ndërsa në kategorinë e grupeve me nevoja specifike të cilat janë mbështetur në skemat e ndryshme për riintegrim kanë përfituar gjithsej 51 familje me 126 anëtarë të riatdhesuar.

Në vijim janë paraqitur të dhënat për mbështetjen e personave të riatdhesuar sipas skemave të përfitimit.


Figura 14: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2018-2020



Burimi: DRPR/MPB/ Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

³⁰ Rregullorja QRK Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, definon grupet e cënueshme kategoritë si në vijim: personat e riatdhesuar të cilët për shkak të sëmundjes, aftësive të kufizuara, gjendjes së tyre familjare, sociale, ekonomike apo moshës, si pasojë e kapacitetit të tyre të kufizuar kanë nevojë për shërbime të veçanta. Përderisa, personat me nevoja specifike konsiderohen personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa specifike gjatë procesit të riintegrit për shkak të statusit të tyre, gjendjes fizike, mendore dhe/ose rrethanave të caktuara familjare apo sociale.

Figura 15: Ndihma për riintegrim të qëndrueshëm, 2018-2020



Burimi: DRPR/MPB/ Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Në kuadër të disa skemave për riintegrim të qëndrueshëm, gjatë periudhës 2019-2020 vërehet një rritje e konsiderueshme në skemën e financimit për themelimin e biznesit, si dhe skemat e tjera, si rezultat i rritjes së bashkëpunimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me organizata ndërkombëtare.

6. Integrimi i të Huajve

Integrimi i të huajve në shoqërinë kosovare është i rregulluar përmes kornizës ligjore që ka të bëjë me Ligjin për të Huaj dhe Ligjin për Azil, si dhe përmes Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve.

6.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

MPB/DRPR është përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e politikave të integritit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante qendrore dhe lokale. Secila nga ministritë relevante parasheh masat e integritit, si pjesë e planit operativ dhe financiar të saj. Ministritë dhe komunat kanë caktuar zyrtarë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të integritit. Monitorimin e zbatimit të politikave të integritit në nivel lokal e bënë MPB/DRPR në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal.

6.2. Politikat dhe korniza ligjore

Korniza kryesore ligjore që rregullon integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila gjithashtu rregullon bazën e sistemit të integritit të huajve në Republikën e Kosovës. Kjo Rregullore është publikuar në Gazetën Zyrtare më 24.07.2019³¹. Rregullorja përcakton procedurat, kriteret dhe institucionet përgjegjëse për integrimin e të huajve në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore në Republikën e Kosovës. Integrimi i të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës është i rregulluar edhe përmes një numri të akteve të tjera ligjore. Kreu IX i Ligjit nr. 04/l-219 për të Huajt (nenet 126 dhe 127), siguron bazën ligjore për kushtet dhe shërbimet e integritit të të huajve në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore, përfshirë përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të promovimit dhe zbatimit të programeve për integrimin e të huajve në shoqëri. Legjislacioni në fuqi garanton të

³¹ Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21006>

drejtën e fitimit të shtetësisë së Kosovës (përmes natyralizimit)³² dhe qasjen në shërbime përkatëse me qëllim të lehtësimit të procesit të integritimit në shoqërinë kosovare.

Në kuadër të zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve, gjatë vitit 2020 janë hartuar dokumentet si në vijim:

- Standardet e Vlerësimit të Nevojave dhe Planit Individual të Integritimit.
- Fletëpalosjet Informative për të huaj.
- Plani Strategjik për ngritjen e kapaciteteve të stafit qendror dhe komunal në fushën e integritimit të të huajve.

Me 11 Shtator 2020 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2020 për kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.³³ Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave si dhe mënyra e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Me 04 Shtator 2020 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 06/2020 për Procedurën dhe Kriteret e Përcaktimit të Statusit të Personit Pa Shtetësi, Mënyra e Fitimit të Shtetësisë për Personin Pa shtetësi dhe për Personin me Status të Refugjatit. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për njohjen e statusit të personit pa shtetësi, të drejtat e personit pa shtetësi, si dhe mënyra e fitimit të shtetësisë për personin me status të pa shtetësisë dhe personit me status të refugjati në Republikën e Kosovës.

Me 27 Korrik 2020 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2020 për Themelimin dhe Përcaktimin e Rregullave të Punës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është themelimi dhe përcaktimi i rregullave të punës së Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për fitimin, humbjen dhe revokimin e shtetësisë si dhe ankesave kundër vendimit për refuzim të njohjes së statusit të pa shtetësisë së Republikës së Kosovës.

³² Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Gazeta e Republikës së Kosovës/Nr. 33/2 shtator 2013, Prishtinë.

³³ Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2020 për Kriteret dhe Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31136>


6.3. Statistikat

6.3.1 Fitimi i Shtetësisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2020, kanë parashtruar kërkesë për fitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës 338 persona, ku 177 kanë fituar shtetësinë, ndërsa 244 personave iu është refuzuar kërkesa për mos plotësimin e kriterëve ligjore. Në krahasim me vitin paraprak, numri i vendimeve për fitim të shtetësisë ka pësuar një rënie prej -39% (290).

Sipas shtetësisë, personat që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës në vitin 2020 janë nga Serbia me 30% (53), Shqipëria me 24% (42), Maqedonia e Veriut me 9% (16) dhe shtete të tjera me 37% (66).

Figura 16: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 2018-2020



Burimi: DSHAM

Gjatë periudhës 2018-2020, trendi e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës është në rënie. Gjatë kësaj periudhe, 816 persona kanë fituar shtetësinë, ku dominon gjinia femërore me 57% (468) krahasuar me gjininë mashkullore me 43% (348).

6.3.2 Skema e integritetit të të huajve

Nga skemat për Integrimin e të huajve, gjatë vitit 2020, kanë përfituar 19 persona që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare, prej tyre 17 persona janë me status të refugjatit dhe 2 persona janë me status të mbrojtjes plotësuese.

Shërbimet e përfitimeve janë elaboruar si në vijim:

- 16 refugjatë janë pajisur me dokumente udhëtimi;
- 3 persona me mbrojtje ndërkombëtare janë përkrahur me skemën e akomodimit me qira si dhe aplikim për asistencë sociale;
- 6 familje me status refugjati dhe 2 familje (7 persona) me mbrojtje plotësuese janë përkrahur me pako ushqimore dhe higjienike (me mbështetjen dhe në koordinim me partnerëve);
- 2 persona kanë përfituar kurse të gjuhës shqipe të cilët kanë përfituar trajnim profesional;
- 2 persona me mbrojtje plotësues kanë përfituar këshillim individual dhe kanë qene të kyçur në aktivitete psiko-sociale;
- 1 person me status të refugjatit ka vijuar studimet universitare (me mbështetjen partnerëve).

7. Migrimi dhe Zhvillimi

Në këtë kapitull pasqyrohen politikat dhe strategjitë zhvillimore të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me migrimin dhe zhvillimin. Fokusi është vënë në prezantimin e mënyrave se si mund të përdoret potenciali i migrimit për qëllime zhvillimore, dërgesat (remitencat) dhe investimet nga diaspora, si dhe politikat e angazhimit të kthimit të ekspertëve nga diaspora (kthimi i dijes).

7.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Nisur nga fakti se Republika e Kosovës ka diasporë të konsiderueshme, rol kryesor në këtë fushë ka Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Krahas saj, edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në fushëveprimin e tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat në mënyrë direkte apo indirekte rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin. Qëllimi i përbashkët i këtyre institucioneve është krijimi i një klime të favorshme për tërheqjen e investimeve në përgjithësi dhe investimeve nga diaspora në veçanti.

Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**, përveç përkushtimit në politikën e jashtme³⁴, angazhohet në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të diasporës, promovimin dhe avancimin e të drejtave të tyre, organizimin e tyre në vendet ku jetojnë, si dhe promovimin e resurseve dhe mundësive për investimet e tyre në vendin e origjinës me qëllim të zhvillimit ekonomik.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale harton politika të punësimit dhe ka rol të rëndësishëm në promovimin e migrimit të rregullt, si dhe në ndërlidhjen e nevojave të tregut të punës me

³⁴ <https://www.mfa-ks.net/politika/481/prioritetet-e-reja-t-politiks-s-jashtme-t-kosovs/481>

migrimin, dhe zhvillon programet përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).

Ministria e Financave angazhohet që përmes politikave fiskale të krijojë klimë të favorshme për investime, duke përfshirë edhe investitorët nga diaspora.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është institucion tjetër i rëndësishëm që ndërlidh migrimin përmes politikave për përmirësimin e ambientit të biznesit siç është promovimi i investimeve dhe eksportit, fuqizimi dhe krijimi i zonave ekonomike, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe forcimi i sektorit privat në përgjithësi.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit përmes hartimit të politikave në sektorin e energjisë, telekomunikacionit dhe minierave synon zhvillimin ekonomik të vendit dhe krijimin e një klime të favorshme për investime.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) përmes politikave të saj siguron ruajtjen e identitetit, (kulturor, gjuhësor) duke krijuar kurrikula të veçanta për pjesëtarët e diasporës, si dhe programe të veçanta arsimore për çështjet e migrimit.

7.2. Politikat dhe korniza ligjore

Programi i Reformave në Ekonomi (PRE) 2020-2022³⁵ është finalizuar në janar 2020, nën udhëheqjen e Ministrit të Financave, si Koordinator Nacional, pas diskutimit për përmbajtjen e masave, konsistencën e tyre me dokumentet përkatëse strategjike dhe rekomandimet e politikave që kanë rezultuar nga Dialogu Ekonomik dhe Fiskal me Komisionin Evropian. Nuk ka pasur ndryshime/azhurnime lidhur me qeverisjen fiskale dhe kornizat buxhetore të cilat do të ndryshonin thellësisht nga vitet e kaluara. Ministria e Financave ka vazhduar përkushtimin në mbajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të pozitës fiskale të vendit edhe në vitin 2020, e që është edhe objektivi kryesor i Qeverisë. Stabiliteti fiskal dhe forcimi tutje i proceseve dhe mekanizmave që sigurojnë këtë stabilitet, ndikojnë direkt në implementimin me sukses të reformave prioritare të

³⁵ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A92C6CA3-928C-41F3-9DA1-63E0D8CE5701.pdf>

Qeverisë, ndërsa kjo më pas ndikon në mbështetjen direkte dhe indirekte të rritjes së aktivitetit ekonomik në sektorin privat. Qeveria synon të ketë një menaxhim të përgjegjshëm të financave publike duke u siguruar se planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet në përputhje të plotë me kornizën fiskale, ashtu siç parashihet me legjislacionin relevant. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zbatimit me përpikëri të rregullave fiskale që paralelisht sigurojnë qëndrueshmëri fiskale dhe stimulim të rritjes ekonomike, siç janë:

- Kufizimi i deficitit buxhetor në 2% të BPV-së (në baza vjetore),
- Kufizimi i rritjes së faturës së pagave me normën e rritjes së BPV-së nominale (më e fundit e disponueshme),
- Investimet shtesë përmes Klauzolës për Investime (në periudhë afatmesme dhe afatgjate),
- Mirëmbajtja e një niveli adekuat të rezervës fiskale (në baza vjetore), dhe
- Kufizimi i borxhit publik në 40% të BPV (në periudhë afatgjate).

Në kuadër të PRE 2020-2022, tek **Masa e reformës 4**: Rritja e konkurrencës në industrinë prodhuese, është ofruar lehtësimi në qasje në financa për NVM-të, përkrahja teknike në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale (klasteret), përkrahja në përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe kalimin në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar dhe rritjen e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës.

Tek **Masa e reformës 9**: Themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale, vlerësohet se ngritja e sigurisë juridike përmes zgjidhjes efikase të kontesteve komerciale nga kjo Gjykatë shërben si stimulim dhe ulje e riskut për zgjerim të bizneseve ekzistuese dhe ndikon në rritjen e investimeve direkte nga kompanitë e huaja dhe diaspora.

Gjatë vitit 2020 është punuar gjithashtu në hartimin e PRE 2021-2023³⁶, i cili pritet të finalizohet në Janar të vitit 2021. Në këtë program, duke marrë parasysh strukturën ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta për rritjen ekonomike, në veçanti situatën e krijuar në vitin 2020 si rezultat

³⁶ PRE 2020-2022 është hartuar aprovuar në Janar 2020. Zbatimi i masave të parapara raportohet në PRE 2021-2023).

i pandemisë globale Covid-19, reformat strukturore janë orientuar në mënyrë të tillë që synojnë rimëkëmbjen e ekonomisë në përgjithësi.

Situata e rënduar me pandeminë Covid-19, ka shtyrë ndërmarrjen e masave restriktive si në fushën e lëvizjes së qytetarëve ashtu edhe të aktiviteteve ekonomike. Në vitin 2020³⁷, masat emergjente dhe të rimëkëmbjes, prej rreth 4.3 përqind të PBB-së, përfshinin alokimet për sistemin shëndetësor (0.4 përqind të PBB-së); shpërblimet e pagave për punonjësit e shëndetit dhe sigurisë për jashtë orarit dhe rritja e rrezikut me të cilën përballen në kryerjen e detyrave të tyre (0.5 përqind e PBB-së), transferet sociale dhe subvencionet për familjet në nevojë (1.6 përqind e PBB-së), si dhe mbështetje për firmat në formën e pagës shtesë dhe qasje më e lehtë në huamarrje (përfshirë NP-të dhe fermat, prej rreth 1.7 përqind të PBB-së), dhe shpenzimet kapitale (më pak se 0.1 përqind e PBB-së). Për të stimuluar kërkesën agregate, kjo pako gjithashtu lejoi tërheqje të parakohshme deri në 10 përqind nga llogaritë e pensioneve të TKPK -së (2.6 përqind e PBB-së), shumica e të cilave (1.8 përqind e PBB-së) do të rimbursohen gradualisht nga buxheti duke filluar në vitin 2023.

Pakoja e Masave Emergjente³⁸ e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 30 Mars 2020, është përgatitur si hap i parë i adresimit të problemeve ekonomike të rezultuara nga pandemia, dhe rrjedhimisht ka përfshirë veprime dhe intervenime që kanë për synim ndihmesën imediate për qytetarët tanë në ato role apo funksione që ata janë dëmtuar nga pandemia (si përfitues i skemave sociale nga shteti, konsumatorë, punëmarrës, qiramarrës apo punëdhënës). Pakoja emergjente fiskale, përmes 15 masave të saj dhe 190 milionë eurove të alokuara në thelb ka pas 8 objektiva.

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike³⁹, fokus primar do të ketë mbështetjen me kredi për secilin biznes që përgjatë periudhës së pandemisë ka hasur në rënie të aktivitetit ekonomik. Por megjithatë pakoja synon që përtej synimit primar të dizajnohen masa që mundësojnë rritje të

³⁷ <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19>

³⁸ Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike; https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IwAR2c6uVrwnmK8WtMFkNO-eNLCi4Heol25BQoP_Ydmq-wc131NTAfh2XVv6Q

³⁹ Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike; https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IwAR2c6uVrwnmK8WtMFkNO-eNLCi4Heol25BQoP_Ydmq-wc131NTAfh2XVv6Q

kapaciteteve prodhuese, rritje të eksporteve e përmirësim të bilancit tregtar, rritje të punësimit dhe formalizimit, përmirësim të strukturës së PBB-së e të ngjashme.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020⁴⁰, Nën-llogaria e dedikuar për donacione dhe Grante, gjatë vitit 2020 ka grumbulluar gjithsejtë 716,773.93 Euro, prej të cilave 667,115.70 Euro nga jashtë Kosovës (duke përfshirë, por jo vetëm mjetet nga diaspora), kurse të brendshme janë 49,658.23 Euro.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19⁴¹, gjatë vitit 2020, janë paraqitur në tabelat në vijim.

Tabela 8: Total pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 (00099+00098)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	33,981,638	33,959,272	100%
Mallra dhe shërbime	27,720,384	23,760,986	86%
Shpenzime komunale	195,759	193,787	99%
Subvencione dhe transfere	231,121,847	227,039,371	98%
Shpenzime kapitale	1,546,094	593,600	38%
Gjithsej	294,565,723	285,547,016	97%

Burimi: MF

Ndërsa, të ndara në dy pjesë (kodi 00099 dhe 00098), paraqiten si në vijim:

⁴⁰ Raporti vjetor financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës, Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf>

⁴¹ Ibid

Tabela 9: Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - Pakoja Emergjente⁴² (00099)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	33,781,638	33,784,096	100%
Mallra dhe shërbime	20,885,865	19,721,517	94%
Shpenzime komunale	143,306	141,348	99%
Subvencione dhe transfere	115,806,351	113,797,341	98%
Shpenzime kapitale	1,546,094	593,600	38%
Gjithsej	172,163,254	168,037,902	98%

Burimi: MF

Tabela 10: Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 – Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike⁴³ (00098)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	200,000	175,176	88%
Mallra dhe shërbime	6,834,520	4,039,469	59%
Shpenzime komunale	52,453	52,440	100%
Subvencione dhe transfere	115,315,496	113,242,030	98%
Gjithsej	122,402,469	117,509,114	96%

Burimi: MF

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Diaspora si potencial për zhvillimin ekonomik të vendit është përfshirë në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, dhe PRE 2019-2021.

⁴² Vendimi i QRK për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, më 30.03.2020; <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-per-Pakon-Emergjente-Fiskale-1.pdf>

⁴³ Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike; https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IwAR2c6uVrwnmK8WtMFkNO-eNLCi4Heol25BQoP_Ydmq-wc131NTAf2XVv6Q

Në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj, MPJD ka vazhduar me zbatimin e politikave për Diasporën, përkatësisht ka përkrahur themelimin e strukturave për organizimin e diasporës si: rrjetet e bizneseve, rrjetet e profesionistëve, rrjetet e të rinjve, Këshillat e diasporës (p.sh Këshilli koordinues i shoqatave shqiptare në Austri) me qëllim të krijimit të urave lidhëse ndërmjet vetë pjesëtarëve të Diasporës dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në bashkëpunim me institucione relevante në vend (KIESA, ATK, Dogana, Odat Ekonomike etj.) dhe atyre në Diasporës (si rrjeti i bizneseve të Diasporës), janë planifikuar një numër i aktiviteteve të cilat për shkak të situatës me pandemi dhe mbylljes së kufijve, të njëjtat janë suspenduar deri në krijimin e kushteve për realizimin e tyre.

Gjatë vitit 2020, Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA)⁴⁴, e cila vepron në kuadër të **Ministritë së Tregtisë dhe Industrisë**, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbështetjes së bizneseve dhe ambientit të bërit biznes, ku gjithsejtë janë mbështetur 84 biznese përmes aktiviteteve si përkrahje financiare të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese (24 biznese përfituese në vlerë totale prej 500,000.00 EUR), mbështetje financiare për NVM në sektorin e digjitalizimit në marrëveshje me ADA-n austriake (18 biznese përfituese në vlerë totale prej 50,000.00 EUR), mbështetje për gratë ndërmarrëse (29 biznese përfituese në vlerë totale prej 400,000.00 EUR) si dhe mbështetje në certifikimin e standardizimit të kompanive në bashkëpunim me projektin e Bankës Botërore “Rritja e konkurrueshmërisë dhe përgatitja për eksport” kanë përfituar 13 biznese në vlerë totale prej 318,570.00 EUR. KIESA, poashtu përmes programit të saj Aftercare (pas investimit), i dedikuar për investitorët e huaj dhe nga Diaspora, ka bërë përditësimin e listës së investitorëve ku gjatë vitit 2020 ka vizituar rreth 300 investitorë në lidhje me lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë.

Gjatë vitit 2020 janë bërë investime në katër zona ekonomike (Suharekë, Vushtrri, Lipjan dhe Viti) ku planifikohen të përgatiten rreth 50 hapësira (parcels) për vendosje të bizneseve të huaja dhe vendore duke pasur gjithnjë parasysh edhe kërkesat e bizneseve të Diasporës. Vlen të ceket

⁴⁴ <http://kiesa.rks-gov.net/>

se Zonat Ekonomike në Kosove janë të rregulluara më Ligjin për Zona Ekonomike, nr. 04/L-159 dhe aktet nënligjore të dala nga ky ligj.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit⁴⁵, gjatë vitit 2020 për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia, korniza e krijimit të politikave ka pësuar ngecje. Mirëpo, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (deri në Qershor 2020 ka funksionuar si Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike) për lehtësimin e gjendjes së krijuar nga pandemia, është fokusuar në hartimin e urdhëresave dhe masave të pakos emergjente ku qëllimi kryesor ishte ofrimi i ndihmës financiare shtesë për skemat sociale të shoqërisë; të ndihmojë bizneset në mbulimin e shpenzimeve operative në mënyrë që të sigurohet një pagë minimale për të gjithë punëtorët gjatë situatës emergjente, si dhe të sigurohet se bizneset kanë mundësi të vazhdojnë veprimtarinë gjatë dhe pas tejkalimit të situatës emergjente.


7.3. Statistikat

7.3.1 Dërgesat e emigrantëve (Remitancat)

Remitancat në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Në vitin 2020, remitancat në Kosovë arritën shumën prej 980.1 milionë euro krahasuar me vitin 2019, ku remitancat arritën vlerën 851.5 milionë. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2020 kanë pasur pjesëmarrje prej 14.4% në bruto produktin vendor (BPV).

⁴⁵ <https://me.rks-gov.net/>

Figura 17: Të hyrat nga remitancat, 2016-2020




Burimi: BQK, 2020

Rreth 83% e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2020 janë transferuar përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshin dërgesat e emigrantëve në mallra dhe mjete të tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jenë nga Gjermania me 42.3% dhe Zvicra me 22.3% të totalit të dërgesave të pranuar në Kosovë duke pasuar me SHBA-të me 6.4%, Austria me 4.6% dhe Italia me 4.1%, dhe Franca me 3.8%.

7.3.2 Investimet e Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë për vitin 2020 arrijnë vlerën prej 341.7 milionë euro, apo 34% më shumë sesa në vitin paraprak. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i IHD-ve në Kosovë gjatë periudhës 2016-2020.

Figura 18: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së, 2016-2020



Burimi: BQK, 2020


Sektorët që kanë pasur trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve gjatë vitit 2020 janë sektorët e patundshmërisë, xehetarisë dhe guroreve, energjetikës dhe ai financiar. Pjesëmarrja e patundshmërisë në gjithsej investimet direkte në Kosovë në vitin 2020 ishte 59%, aktivitetet financiare me 25%, energjetikës 8%, dhe xehetaria dhe guroret me 8%.

7.3.3 Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve në Kosovë / Turizmi i Diasporës në Kosovë

Kosova gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit janë rritur vazhdimisht që nga viti 2013 duke arritur në 1,321.4 milion euro në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 për arsye të pandemisë dhe mbylljes totale për disa muaj, vlera e turizmit ka rënë për 52.5%, duke shënuar vlerën 628.0 milion euro.

Pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, rreth 90%, i atribuohet diasporës.


Figura 19: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve, 2016-2020



Burimi: BQK, 2020

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në bruto produktin vendor ku remitancat përbëjnë rreth 14.4% të BPV-së, shërbimet e udhëtimit të diasporës përbëjnë 8% dhe nga përqindja e pjesëmarrjes së IHD-ve në patundshmëri me 2.6%, siç është paraqitur në Figurat 14, 15 dhe 16. Duke pasur parasysh se shuma e këtyre tre komponentëve përbën rreth 26% të bruto produktit vendor, të hyrat përkatësisht nga migrimi janë faktor i rëndësishëm për të mundësuar konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 20: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora



Burimi: BQK, 2020

8. Azili

8.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Divizioni për Azil në kuadër të DSHAM/MPB është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurës së azilit. Qendra për Azil është përgjegjëse për pranimin dhe akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare gjatë procedurës së përcaktimit të statusit. Komisioni Kombëtar për Refugjatë (KKR) është organ kompetent në shkallë të dytë për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë.

Policia Kufitare e PK-së është përgjegjëse në procedurën fillestare, e cila përfshin parashtrimin e aplikacioneve, intervistën fillestare, marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe fotografive dhe transferimin e aplikuesve në Qendrën për Azil.

8.2. Politikat dhe korniza ligjore

Gjatë vitit 2020, ka filluar procesi i hartimit të disa akteve nënligjore dhe dokumente udhëzuese në fushën e azilit, si në vijim:

- Hartimi i Rregullores për Punën e Sigurimit në Qendrën për Azil;
- Hartimi i Planit të Emergjencës për Qendrën e Azilit;
- Plotësim-ndryshimi i Udhëzuesit për Kushtet e Pranimi për Azil më Nevoja të Veçanta;
- Rishikimi i Planit të Reagimit në Rast të Fluksit të Migrantëve.

Sa i përket masave kundër pandemisë Covid-19, Qendra e Azilit ka ndërmarrë masa të nevojshme komfort vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19. Këto masa janë përkrahur nga institucionet e specializuara vendore si IKSHPK dhe MSH dhe organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si UNHCR, IOM, JRS, UNICEF, EXBS, ICITAP dhe GIZ.


8.3. Statistikat

8.3.1 Azilkërkuesit në Kosovë

Numri i azilkërkuesve në Kosovë gjatë vitit 2020 ka qenë 1,409 duke shënuar rënie prej -32% në krahasim me vitin paraprak 2019 (2,081).

Numri i azilkërkuesve në Kosovë kryesisht ishin nga : Siria 649 (46%), Maroku 183 (13%), Palestina 121 (8.6%), Iraku 119 (8.4%), Libia 89 (6.3%) kurse shtetet e tjera 248 (17.6%). Grup-mosha më e përfaqësuar është 18-34 vjeç me 71.5%, 35-64 vjeç me 14.5%, 0-13 vjeç me 8.4%, grup-mosha 14-17 vjeç me 5.5%, dhe grup-mosha 65+ me 0.1%.

Figura 21: Azilkërkuesit në Kosovë sipas grup-moshës, 2018-2020



Burimi: DSHAM/MPB

Nga numri i përgjithshëm i azilkërkuesve gjatë vitit 2020 (1,409), persona të rritur ishin 1,219 (87%), fëmijë 146 (10.4%) dhe 44 (3.1%) fëmijë të pashoqëruar.

Sipas gjinisë, dominon gjinia mashkullore me 1,261 (89.5%) përderisa gjinia femërore përfaqësohet me 148 (10.5%).

Sipas statusit të vendimeve, gjatë vitit 2020 janë nxjerrë 1,238 vendime të shkallës së parë: 83% (1,168) të tyre u është ndërprerë procedura, 2.9% (40) ndërprerje vullnetare të procedurës, 0.42% (6) vendim lidhur me njohjen e statusit të refugjatit, 0.49% (7) refuzim sipas procedurës së përshpejtuar dhe 1.2% (17) në pritje të vendimit.

Azilkërkuesve u janë ofruar shërbimet shëndetësore falas, ndihma juridike dhe administrative, asistencë sociale dhe psikologjike, shujta ditore, veshmbathje, pako higjienike dhe forma të tjera të ndihmës fizike. Gjithsej janë ofruar 1,411 shërbime mjekësore, 888 shërbime juridike falas, 1,000 këshilla sociale dhe kurse të gjuhës shqipe.

8.3.2 Azilkërkuesit kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen


Në vitin 2020, numri i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë⁴⁶ nga shtetasit Kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Shengen⁴⁷, ishte 1,530 persona, që krahasuar me numrin e përgjithshëm të kërkesave për azil⁴⁸ (2,265 persona), ishte për 730 persona ose - 48% më i ulët. Të dhënat për numrin e kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë në vitin 2020, tregojnë se kishte rënie të dukshme prej rreth - 94%, krahasuar me vitin 2019 (2,965 persona). Kjo rënie e dukshme ka qenë në vazhdimësi që nga viti 2018, por gjithashtu më e ultë nga të gjitha vitet paraprake. Rënia mund t'i atribuohet pandemisë Covid-19 dhe kufizimeve të ndërlidhura me udhëtimet të zbatuara nga Shtetet Anëtare të BE-së por edhe masave parandaluese të ndërmarra nga autoritetet vendore si dhe pezullimit të përkohshëm të procesit të ripranimit.

⁴⁶ Një aplikant për herë të parë për mbrojtje ndërkombëtare është një person që paraqet një kërkesë për azil për herë të parë në një shtet të caktuar anëtar të BE-së dhe për këtë arsye përjashton aplikantët e përsëritur (në atë Shtet Anëtar) dhe kështu reflekton më saktë numrin e personave të sapoardhur që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetin Anëtar raportues.

⁴⁷ https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_asyappctza&lang=en, e përditësuar më, 13 prill 2021 dhe tërhequr/marrë më, 07 qershor 2021.

⁴⁸ Aplikant për azil i referohet një shtetasi të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi që ka depozituar një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ose që është përfshirë në një aplikim të tillë si anëtar i familjes në lidhje me të cilin nuk është marrë akoma një vendim përfundimtar gjatë periudhës së referencës.

Figura 22: Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe të zonës Shengen, 2018-2020



Burimi: Eurostat

Nga numri i përgjithshëm i të gjithë aplikuesve për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen (428,650), aplikuesit për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë me shtetësi kosovare, përbënin 0.357%.

Të dhënat sipas gjinisë, tregojnë se meshkujt përbënin dy të tretat (960, ose 63%) të numrit të përgjithshëm të aplikuesve për herë të parë në vitin 2020, në krahasim me gjininë femërore e cila përbënte (565, ose 37%).

Më shumë se tre të katërtat (1,165 ose 77%) e azilkërkuesve kosovarë për herë të parë në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen në vitin 2020, ishin më pak se 35 vjeç, ata të moshës 18-34 vjeç përbënin (600 ose 40%) të numrit të përgjithshëm të aplikuesve për herë të parë, ndërsa pothuajse një e treta (350 ose 37%) e numrit të përgjithshëm të aplikuesve për herë të parë ishin të mitur të moshës më pak se 18 vjet.⁴⁹

⁴⁹ I mituri i pashoqëruar është një person nën moshën 18 vjeç, i cili arrin në territorin e një Shteti Anëtar të BE-së, dhe është i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës për të miturin ose një i mitur i cili mbetet i pashoqëruar pasi të ketë hyrë në territorin e një Shteti Anëtar.

Vendet kryesore të destinimit të aplikuesve për azil për herë të parë të shtetasve kosovarë mbetën të pandryshuara nga viti 2019. Me 865 aplikues të regjistruar në vitin 2020, Franca zinte vendin e parë me 57%, të gjithë aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare për herë të parë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen. Ajo u pasua nga Gjermania (260, ose 17%), Italia (95, ose 6%), Suedia (85, ose 5.8%), Zvicra me (60, ose 4%) dhe shtetet tjera me numër nën 4%.

9. Përfundimet dhe rekomandimet

9.1. Përfundimet

Shpërthimi i pandemisë Covid-19 në fillim të vitit 2020 ka prekur sektorët e ndryshëm të ekonomisë në aspektin global duke ndikuar edhe në lëvizjet migratore. Masat e ndërmarra në menaxhimin e pandemisë si mbyllja e kufijve dhe masat tjera restriktive ka ndikuar që emigrimi i shtetasve të Kosovës të pësoj rënie të dukshme krahasuar me vitet paraprake, përderisa tek imigrimi ka ndikuar në ngritje. Në kategoritë e imigrantëve për vitin 2020, përveç kategorive si: të kthyerit/ripranuarit , azil-kërkuesit dhe të huajt me leje-qëndrime të vlefshme në Republikën e Kosovës, është për tu theksuar kthimi (riatdhesimi) i shtetasve të Republikës së Kosovës nga vendet e rajonit si Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, si dhe të rinjtë me qëllime studime në vendet e ndryshme Evropiane dhe më gjerë. Humbja e vendeve të punës si rezultat i mbylljes dhe masave tjera restriktive të ndërmarr nga vendet Evropiane mund të ketë ndikuar që një numër i shtetasve të Kosovës të kthehen në Kosovë duke rritur numrin e imigrantëve sipas definicioneve dhe metodologjisë që përdor ASK-ja.

Edhe përkundër mbylljes së kufijve dhe masave tjera kufizuese të ndërmarr nga Qeveria e Republikës së Kosovës, numri i migrantëve të parregullt që kanë hyrë në Republikën e Kosovës është rritur krahasuar me vitin paraprak, si dhe kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo ka ndikuar që institucionet e Republikës së Kosovës të rrisin kapacitetet pritëse dhe akomoduese për migrantët e parregullt si dhe të ndërmarrin masa për mbrojtjen e migrantëve nga pandemia.

Edhe përkundër faktit që pandemia ka ndikuar negativisht në ekonominë ku është e koncentruar diaspora Kosovare, remitencat për vitin 2020 janë rritur dukshëm krahasuar me vitet paraprake. Kjo për arsye se vizitat e pjesëtarëve të diasporës gjatë vitit 2020 janë zvogëluar dukshëm dhe janë shfrytëzuar kanalet formale për dërgesat e parave tek anëtarët e familjeve në Kosovë.

9.2. Rekomandimet

1. Gjatë rishikimit të Ligjit për të Huaj, rekomandohet që APRK ti ketë përgjegjësitë e lëshimit të lejeve të punës, përderisa leje-qëndrimet të lëshohen nga MPB, pas aprovimit të lejes së punës afatgjate nga APRK.
2. Shqyrtimi i mundësive për negociim dhe nënshkrim të marrëveshjeve bilaterale ose memorandumeve të mirëkuptimit për migrim për qëllime punësimi me shtetet e rajonit si dhe me shtetet anëtare të BE-së, në veçanti ku janë të koncentruar emigrantet me origjinë nga Kosova.
3. Zbatimi i marrëveshjes së mobilitetit për punë të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, në kuadër të zbatimit të politikave rajonale dhe lehtësimit të mobilitetit për punë palët angazhohen të punojnë me institucionet përkatëse në lehtësimin e procedurave administrative për qasje të lirë në tregun e punës. Dispozitat e kësaj marrëveshje të parashihen gjatë rishikimit të Ligjit për të Huaj.
4. Hartimi i politikave që kanë për qëllim promovimin e dërgesave (remitencave) përmes kanaleve formale, duke synuar uljen e kostos së transferit.
5. Krijimi i Këshillit të Përgjithshëm të Diasporës, që ka për qëllim avancimin e interesave të komunitetit të diasporës dhe krijimin e kushteve për investime nga diaspora me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.
6. Avancimi i mëtejshëm i sistemit të integritetit të të huajve.
7. Avancimi i sistemit të kthimit të imigrantëve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë bashkëpunimin rajonal dhe me mekanizmat e BE-së.
8. Promovimi i politikave për kthim vullnetar, në veçanti përmes zbatimit të marrëveshjes në mes të MPB-së dhe IOM-it.
9. Avancimi i mekanizmave për të menaxhuar flukset e përziera të migracionit.

10. Përditësimi në baza vjetore, apo sipas nevojës, të Planit të Reagimit për menaxhimin e flukseve me migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtjes ndërkombëtare.
11. Avancimi dhe Integrimi i sistemeve informative që mbajnë të dhëna të Migrimit
12. Monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Migrimit 2021-2025 dhe politikave tjera të ndërlidhur me fushën e migrimit.